



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 53, Datë 03.04.2019

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR KRITERET
STANDARDE MINIMALE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT DHE FURNIZIMIT TË
RRJETEVE TË GAZIT NATYROR”.**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe të nenit 16, pika 18; nenit 48, pika 5; nenit 53 pika 5; nenit 89, pika 1 dhe 7; nenit 89, nenit 94 pikat 5 dhe 8 të Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror" i ndryshuar, si dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 03.04.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për kriteret standarde minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror”.

Konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror" i ndryshuar, nenit 16, pika 18, ERE ka kompetencën të hartojë Draft –“Rregulloren për kriteret standarde minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror”.
- Ky draft është hartuar në respektim të parashikimeve të dispozitave të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, duke dhënë orientim në lidhje me kriteret standarde minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror.
- Duke qënë se kërkesat minimale për cilësinë e shërbimit dhe furnizimit të sektorit të energjisë elektrike janë tashmë në një fazë të avancuar në sektorin e gazit natyror në nivelin e BE-së dhe Komunitetit të Energjisë (EnCom), lind nevoja të miratohen nga ERE edhe kërkesat për cilësinë e shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror, duke ndjekur të njëjtën rrugë.

- Këshilli i Rregullatorëve Evropianë të Energjisë (CEER), për herë të parë e përfshiu gazin natyror në Raportin e tij të 6-të BENCHMARKING, mbi cilësinë e furnizimit me energji elektrike dhe gaz në vitin 2016, ndërsa raporti i parë në nivel EnCom "Cilësia e Shërbimeve të Shpërndarjes dhe Furnizimit të Gazit në Komunitetin e Energjisë " u botua në Nëntor 2018.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullores për kriteret standarde minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror”.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 diteve nga data e marrjes së vendimit, në ERE dhe të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit Ahmeti